



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2265/11 prot

Datë 03.12.2025

V E N D I M

Nr. 1769/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.12.2025 me,

Objekt: Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-58162-08-14-2025, me objekt: “Shpenzime per D.D.D”, me fond limit 3,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 25.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore.

Autoriteti Kontraktor: Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore, me adresë Lagjja Kushtrimi, ish Parku i Autobusave Vlorë.

Ankimues: Operatori ekonomik “EGIAN MED” SHPK, me NIPT L71715003C dhe adresë Njësia Bashkiake Nr.7, Rruga e Kavajës, Godina "Condor Centre", Kati 4.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së

Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.08.2025 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-58162-08-14-2025, me objekt: “Shpenzime për D.D.D”, me fond limit 3,500,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me datë 25.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore.

II.2. Në datën 21.08.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5721 dhe me nr. 2265 prot., datë 22.08.2025 e operatorit ekonomik “Egian Med” SHPK me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 2, të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 2265/1 prot., datë 19.09.2025, është dërguar nga Komisioni i Prokurimit Publik kërkesa për informacion te autoritetit kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore lidhur me trajtimin e ankesës se operatorit ekonomik ankimues “Egian Med” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 917/1 prot., datë 23.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2265/2 prot., datë 26.09.2025, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke informuar se rezulton se procedura e mësipërme e prokurimit është e anuluar dhe konstatohet e hequr nga sistemi i prokurimeve elektronike, duke e bërë të pamundur shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

II.6. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor, është dërguar nga Komisioni i Prokurimit Publik kërkesa për informacion nëpërmjet shkresës nr. 2265/3 prot., datë 30.09.2025 te autoritetit kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore lidhur me kthimin në sistemin operacional të portalit të prokurimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. 2265/4 prot., datë 13.10.2025, është ridërguar nga Komisioni i Prokurimit Publik kërkesa për informacion te autoritetit kontraktor Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore lidhur me kthimin në sistemin operacional të portalit të prokurimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.8. Nëpërmjet shkresës nr. 917/3 prot., datë 10.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2265/5 prot., datë 16.10.2025, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor që lidhur me kthimin në sistemin operacional të portalit të prokurimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik të procedurës së prokurimit të sipërcituar i është drejtuar APP me të njëjtën kërkesë.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 917/5 prot., datë 15.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2265/6 prot., datë 20.10.2025, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor që lidhur me kthimin në sistemin operacional të portalit të prokurimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik të procedurës së prokurimit të sipërcituar duke theksuar se i është drejtuar APP me të njëjtën kërkesë dhe që sapo të vihen në një përgjigje prej APP do të na informonin.

II.10. Nëpërmjet shkresës nr. 2265/7 prot., datë 28.10.2025, është dërguar përsëri nga Komisioni i Prokurimit Publik kërkesa për informacion kësaj rradhe te Agjencia e Prokurimeve Publike dhe Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore lidhur me kthimin në sistemin operacional të portalit të prokurimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

II.11. Nëpërmjet shkresës nr. 2265/8 prot., datë 11.11.2025, është ridërguar përsëri nga Komisioni i Prokurimit Publik kërkesa për informacion te Agjencia e Prokurimeve Publike dhe Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore lidhur me kthimin në sistemin operacional të

portalit të prokurimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “EGIAN MED” SHPK për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Nëpërmjet shkresës nr. 917/1 prot., datë 23.09.2025, protokolluar me tonën me nr. 2265/2 prot., datë 26.09.2025, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke informuar se rezulton se procedura e mësipërme e prokurimit është e anuluar dhe konstatohet e hequr nga sistemi i prokurimeve elektronike, duke e bërë të pamundur shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.2. Neni 2 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.1.3. Në nenin 3 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.4. Në nenin 21 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”*

III.1.5. Në nenin 94, pika i “Paraqitja e ankesave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik.”*

III.1.6. Në neni 98 pika 1/ç dhe pika 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: a) në procedurat me faza nuk është dorëzuar asnjë kërkesë e përshtatshme; b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme; c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme; ç) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar; d) kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj. 2. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në pajtim me shkronjën “ç” të pikës 1 të këtij neni, autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt prokurimi e me të njëjtat të dhëna. 3. Autoriteti ose enti kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi ndaj ofertuesve që kanë paraqitur oferta për vendimin e marrë në bazë të pikës 1 të këtij neni. 10 4. Autoriteti ose enti kontraktor u komunikon të gjithë kandidatëve ose ofertuesve vendimin dhe arsyet për të mos e vazhduar procedurën e prokurimit menjëherë, por jo më vonë se 3 ditë nga marrja e vendimit. 5. Autoriteti ose enti kontraktor publikon vendimin e anulimit vetëm pas kalimit të afateve të ankimimit sipas parashikimeve të nenit 110 të këtij ligji.”*

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik, duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.1.8. Sa më sipër, konstatohet se autoriteti kontraktor në aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ka informuar se njëkohësisht ka anuluar këtë procedurë prokurimi prej nga ku Komisioni konstaton se ankesa e operatorit ekonomik ka rënë në dekadencë, pasi referuar parashikimeve të nenit 94, pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, interesi i ligjshëm i ankimuesit është i lidhur me veprimet apo mosveprimet e autoritetit kontraktor,

ndërsa në rastin konkret veprimi i autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës, krijon konfuzion dhe pamundësi për Komisionin e Prokurimit Publik të shqyrtimit të kësaj ankese, pasi ashtu sic dhe cituar në rrethanat e këtij vendimi pikat II.5 dhe II.6, pasi procedura konstatohet e hequr nga sistemi operacional i portalit të prokurimeve publike të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Sa më sipër pretendimi i ankmuesit qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “EGIAN MED” SHPK për procedurën e “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-58162-08-14-2025, me objekt: “Shpenzime per D.D.D ”, me fond limit 3,500,000.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 25.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Ndermarrja e Sherbimeve Publike Vlore.
2. Autoriteti kontraktor të vijoj me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “EGIAN MED” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

